



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.14/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga Zyra Ligjore e KALLXO.com përmes,- Zyrta Ligjor/Hulumtues në BIRN, Prishtinë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 21.10.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga Zyra Ligjore e KALLXO.com përmes,, Zyrta Ligjor dhe Hulumtues në BIRN, Prishtinë, ndaj gjyqtarit, për shkelje disiplinore nga neni 5 par.1 pika 1.2 dhe par.2 pika 2.13 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 22.09.2021, Zyra Ligjore e KALLXO.com përmes,- Zyrta Ligjor/Hulumtues në BIRN, Prishtinë, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë,, me arsyetimin se vlerësojnë se i njëjti ka dhënë informata çorientuese për autoritetin kompetent gjatë kohës kur është marrë në pyetje si dhe në rastin kur e ka shkelur Kodin e Procedurës Penale gjatë trajtimit të një çështje gjyqësore e cila është në zhvillim e sipër në Gjykatën Themelore në Pejë. Pretendimin se gjyqtari ka ofruar informata çorientuese në procedurën disiplinore e arsyejnë me faktin se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit, e parashtruar muaj më parë ishte refuzuar nga autoriteti kompetent pasi ishte vlerësuar si i pabazuar ndonëse, pretendimit për shkelje të Kodit të Procedurës Penale nga gjyqtari, nuk i është dhënë përgjigje. Të njëjtit, pasi kanë analizuar vendimin AD/GJTHPE/nr.11/21 si dhe deklaratat e gjyqtarit, si Zyra Ligjore, i janë drejtuar Prokurorisë Themelore në Pejë, me kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore kundër prokurores së rastit, ku autoriteti kompetent, Kryeprokurori, e ka refuzuar kërkesën në fjalë mirëpo, arsyetimi i dhënë dhe provat e ofruara nga Prokuroria Themelore në Pejë, dërgojnë në përfundimin se gjyqtari ka ofruar Informata çorientuese para autoritet kompetent kur ka deklaruar se caktimi i seancës është bërë në konsultim me prokuroren e rastit Konkretisht, në vendimin AD/GJTHPE/nr.11/21, gjyqtari përshkruhet të ketë thënë "...Pasi e ka parë se koha e ndalimit ishte me datë 24.06.2021, në ora 00:20 gjithnjë duke llogaritur se është brenda afatit ... në konsultim me prokuroren kujdestare janë dakorduar përmes telefonit për mbajtjen e seancës me datë 26.06.2021, në ora 17:00", me rastin e dhënies së deklaratës se tij para autoritetit kompetent, gjyqtari nuk ka dhënë informatat si faktin që prokurorja e rastit tri herë e ka

paralajmëruar atë për dorëzimin e kërkesës dhe ka kërkuar ta dijë për datën dhe orën e mbajtjes së seancës dëgjimore, për të cilat kontakte Prokuroria Themelore në Pejë sipas njoftimit ka mbajtur edhe shënime zyrtare sipas të cilave thuhet se fillimisht pasi e ka dërguar kërkesën për caktimin e paraburgimit, prokurorja, me datë 24.06.2021, në orën 14:45 minuta e ka telefonuar gjyqtarin dhe i ka treguar për kërkesën e parashtruar si dhe ka kërkuar që të njoftohet për caktimin e seancës dëgjimore, në të njëjtën datë prokurorja e ka marrë përsëri në telefon gjyqtarin për ta pyetur se kur do të caktohet seanca ndërsa, i njëjti e ka informuar se do ta caktojme me kohë. Të nesërmen, me datë 25.06.2021, prokurorja e thërret sërish gjyqtarin në telefon gjatë periudhës sa kërkesa ishte akoma në afat për tu vendosur dhe njoftohet nga gjyqtari se seanca do të mbahet me datën 26.06.2021, pasi i pandehuri është liruar në procedurë të rregullt si rezultat i veprimeve të gjyqtarit, prokurorja ka përpiluar ankesë në lidhje me shkeljet e gjyqtarit. Pra, me këtë konsiderojnë se gjyqtari ka ofruar informata çorientuese që ndërliken me procedurat disiplinore e të cilat parashihen si shkelje disiplinore sipas nenit 5, pika 2.13 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore, pasi që i njëjti nuk ka ofruar informata të sakta siç është fakti që tre herë është kontaktuar nga prokurorja për caktimin e seancës andaj, në rastin konkret, prokurorja nuk është dakorduar për mbajtjen e seancës jashtë afatit por ka insistuar tre here radhazi që ajo të mbahet në afat ndërsa, ditën kur ka biseduar me gjyqtarin nuk është dakorduar por është njoftuar lidhur me datën kur gjyqtari e ka caktuar seancën dhe për këtë ka shënime zyrtare në Prokurorinë e Pejës.

Sa i përket pretendimit për shkelje disiplinore nga neni 5, par.1.2 i Ligjit për Procedurën Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror, kanë theksuar se shkelja e ligjit është konsideruar si shkelje e detyrave të punës, në rastin konkret shkelje e ligjit konsiderohet shkelja e Kodit të Procedurës Penale për të cilën pikë kanë theksuar se nuk është vendosur fare në aktvendimin AD/GJTHPE/.nr.11/21 kur është refuzuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore për dy pikat e tjera të kërkesës. Lidhur me këtë kanë shtuar se neni 164 par.10 i Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar qartë se brenda 48 orëve nga arrestimi, i pandehuri duhet të paraqitet para gjyqtarit të procedurës paraprake i cili e mbanë seancën dëgjimore “sa me parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda dyzetetë (48) orëve nga arresti, gjyqtari i procedurës paraprake mban seancën dëgjimore për të vendosur nëse i pandehuri duhet të mbahet në paraburgim”, në rastin konkret gjyqtari nuk ka vepruar sipas këtij neni, pra e ka shkelur nenin 164 paragrafi 10 të KPRK-së andaj, konsiderojnë se ka rënë ndesh me nenin 5 paragrafi 1.2 të Ligjit për Procedurën Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror meqenëse, lëshimi i afatit të përcaktuar nënkupton shkelje ligjore. Përfundimisht, kanë shtuar se duke e pasur parasysh se veprimet e tilla të gjyqtarit, mund ta dëmtojnë reputacionin e gjykatës dhe besimin e publikut në gjyqësor për faktin se një i dyshuar për dhunë në familje dhe lëndim trupor është liruar në procedurë të rregullt për fajin e mos veprimit të gjykatës, të njëjtit kanë kërkuar nga autoriteti kompetent të kërkojë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Me datë 22.09.2021, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarit

Gjyqtari, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se mbetet pranë deklaratimit me shkrim të dhënë me datë 02.08.2021 dhe shton se për asnjë moment pretendimet e tij, nuk kanë qenë në fokus për ta çorientuar autoritetin kompetent që përmes deklaratës së dhënë të nxjerrë vendim jo meritor siç pretendon parashtruesi

i Zyrës Ligjore të Kallxo.com, duke u thirrur në atë se me deklaratimet jo të sakta të gjyqtarit, autoritetin kompetent e ka sjellë në situatë që të nxjerrë Aktvendimin me të cilin është refuzuar kërkesa si e pa bazuar. Gjyqtari ka shtuar se pavarësisht referimit të deklaratimit të prokurores përmes Shënimit Zyrtar të saj, përmbajtjen e të cilave nuk i di, i njëjti përmes deklaratës së parë ka sqaruar se kërkesën e ka pranuar në zyrë, me datë 25.06.2021 dhe thirrjet e prokurores të bëra para se gjyqtari ta pranojë kërkesën, për asnjë moment nuk i mohon, ashtu që nga thirrjet e saja, e sidomos nga thirrja e parë e datës 24.06.2021, gjyqtari ka theksuar se ka marrë një njoftim pritës në lidhje me kërkesën e jo më shumë, përderisa nga thirrja tjetër siç potencohet se e ka bërë të njëjtën ditë akoma pa mbërritur kërkesa, të dy këto thirrje që ndërlidhen me datën 24.06.2021, kanë qenë thirrje të saja, për të kuptuar prokurorja se a e ka pranuar gjyqtari kërkesën e saj për caktimin e masës së sigurisë të propozuar nga ana e saj, e jo si vënie në dijeni se kemi skadim të afatit dhe tërheqje vëmendjes së gjyqtarit se me datën 25.06.2021, përkatësisht me fillim të datës 26.06.2021, kemi të bëjmë me skadim ndalimi, për të cilin gjyqtari ka sqaruar se nuk është obligative por, si shenjë bashkëpunimi nga ana e saj, nëse ka qenë në dijeni pasi që, gjyqtari edhe një herë ka sqaruar se për shkak të ngarkesës me punë është vënë në lajthim me kohën e ndalimit, e që ka qenë pas mesnate, e të cilin fakt nuk e ka mohuar asnjëherë. Gjyqtari, ka pohuar se është e vërtetë që prokurorja e ka telefonuar dhe të njëjtës i ka treguar se “po e mbajmë nesër me datë 26.06.2021 diku pas dite” gjithnjë duke menduar se është brenda afatit dhe prokurorja i është përgjigje duke theksuani se e kam edhe një rast tjetër, me përpilim kërkesë apo me mbajtje seance paraburgimi, nëse nuk gabohet në Istog. Këtë, gjyqtari ka shtuar se e ka marrë si dakordim pajtimi të mbajtjes së seancës duke menduar gjithnjë që janë brenda afatit kohor i cili afat si tillë është keqkuptuar fillimisht nga ana e gjyqtarit. Gjithashtu, vetë paraqitja e prokurores në seancë me datë 26.06.2021, në orën e caktuar, komunikimi i saj me kapitenin, rreshterin, policin e rastitdhe se fundmi me Kryeprokurorin, duke shfaqur pakënaqësinë e saj për lëshimin e të pandehurit duke menduar se është lëshuar para skadimit të afatit, jep bindjen për keqkuptim afati. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës për shkelje të ligjit, gjyqtari ka sqaruar se seanca është caktuar me datë dhe kohë lajthitëse nga ana e gjyqtarit, pas mbajtjes së seancës ka nxjerrë Aktvendimin DP.PP.nr.178/21, më të cilin është refuzuar kërkesa si jo lëndore dhe palët janë udhëzuar në të drejtën e ankesës ashtu që ndaj këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë prokurorja. Gjykata e Apelit çështjen e ka kthyer në rivendosje, nga Zyra për Menaxhimin e Lëndëve Penale dhe përmes sistemit ka kuptuar se ndaj të pandehurit është ngritur aktakuza andaj, në respektim të asaj se tani çështja penale vazhdohet nga një gjyqtari tjetër pas ngritjes së aktakuzës, në këto rrethana, çështja është jo lëndore dhe si gjyqtar i procedurës paraprake ka përpiluar Shënim Zyrtar DPPP.nr.178/21, me datë 23.07.2021.

Mbi të theksuarat, gjyqtari ka shtuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa baza, me një ngarkesë për një vendimmarrje të sërishme tani, duke kërkuar që të vendoset për shkelje të Ligjit Penal përkundër që për këtë bazë tani, ka një vendim nga Gjykata e Apelit.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar dhe deklaratën e gjyqtarit ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Parashtruesi i ankesës disiplinore, ka shprehë pretendimet se gjyqtari, ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.13 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve me arsyetimin se me rastin e dhënies së deklaratës së tij në procedurën disiplinore AD/GJTHPE/nr.11/21, ka ofruar deklarata çorientuese duke theksuar se me prokuroren e shtetit është dakorduar për mbajtjen e seancës me datë 26.06.2021, në ora 17:00 si dhe nuk ka ofruar informata të sakta siç është fakti se prokurorja e shtetit e ka kontaktuar tre herë gjyqtarin për caktimin e seancës dhe e njëjta ka insistuar që seanca të mbahet me afat.

Pretendimet e tilla të parashtruesit të ankesës se gjyqtari ka dhënë informata çorientuese me arsyetimet si më lartë, nuk qëndrojnë për arsye se në deklaratën e tij, gjyqtari ka sqaruar se në njërin nga komunikimet e tij me prokuroren, përmes telefonit të njëjtës i ka thënë “po e mbajmë seancën nesër me datë 26.06.2021 diku pas dite” për çka prokurorja i është përgjigje e fjalën “ani..” dhe e njëjta është paraqitë në seancë në datën dhe orën e caktuar. Pohimin e tillë të prokurores, moskundërshtimin nga ana e saj për mbajtjen e seancës në datën dhe orën e përmendur nga gjyqtari dhe vetë paraqitjen e prokurores në gjykatë për seancë, gjyqtari e ka konsideruar si dakordim me prokuroren për mbajtjen e seancës andaj, në këto rrethana, deklarimi i gjyqtarit se “është dakorduar me prokuroren për mbajtjen e seancës”, nuk mund të konsiderohet si informatë çorientuese. Për më tepër, fakti se a janë dakorduar apo jo gjyqtari i procedurës paraprake dhe prokurorja e çështjes për datën dhe orën e mbajtjes së seancës për caktimin e masës së sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurë, ka qenë krejtësisht irelevant në raport me shkeljen e pretenduar disiplinore për të cilën ishte parashtruar ankesa disiplinore ndaj gjyqtarit, lidhur me të cilën gjyqtari kishte dhënë deklaratën në fjalë.

Ndërsa, lidhur me pretendimin se gjyqtari, në deklaratën e tij të dhënë në çështjen disiplinore AD/GJTHPE/nr.11/21, nuk ka ofruar informata të sakta siç është fakti se prokurorja e shtetit e ka kontaktuar tre herë gjyqtarin për caktim të seancës dhe e njëjta ka insistuar që të mbahet në afat, Kryetari i Gjykatës, në cilësinë e autoritetit kompetent gjen se nuk është kontestuese se prokurorja e ka kontaktuar gjyqtarin tri herë përmes telefonit por, në bazë të provave në shkresat e lëndës nuk ka mundur të vërtetohet se prokurorja me rastin e komunikimit përmes telefonit ka insistuar që seanca të caktohet dhe të mbahet brenda afatit apo, ashtu siç ka deklaruar gjyqtari, e njëjta e ka kontaktuar për ta njoftuar se e ka dorëzuar një propozim, për t’a pyetur se a e ka pranuar gjyqtari lëndën dhe për t’a pyetur se kur do të caktohet seanca e jo, për të insistuar që seanca të caktohet.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së Aktvendimin AD/GJTHPE/nr.11/21, autoritetit kompetent nuk ka vendosur lidhur me pikën e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit, për shkak të shkeljes së ligjit, konform nenit 5 par.1 pika 1.2 të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Kryetari i Gjykatës, në cilësinë e autoritetit kompetent vlerëson se lidhur me shkeljen apo jo të ligjit nga ana e gjyqtarit në çështjen penale paraprake, është kompetent për të vendosur Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, për çka edhe lënda paraprake në fjalë ishte dërguar në gjykatën në fjalë sipas ankesës së prokurores së shtetit.

Kryetari i Gjykatës, në cilësinë e autoritetit kompetent pas vlerësimit të ankesës disiplinore dhe përgjigjes së gjyqtarit të çështjes ka gjetur se gjyqtari nuk ka kryer shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 par.1 pika 1.2 dhe par.2 pika 2.13 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ashtu siç pretendon parashtruesi i ankesës, e as shkelje të tjera disiplinore të parapara me këtë ligj. Andaj, ankesa e tillë disiplinore refuzohet si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.14/21, me datë 21.10.2021.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit*
- 3. Parashtruesit të ankesës –,
Kallxo.com – BIRN Prishtinë*